

TETOVA'S 68 IN THE CONTEXT OF YUGOSLAV AND INTERNATIONAL CIRCUMSTANCES

Zeqirja Rexhepi

Abstract

Albanian demonstrations of 1968 in Macedonia are part of the nationwide resistance in the former Yugoslavia. These have developed as a result of anti-Albanian politics after the Second World War.

In this paper I will try to deal with the events of 1968 (with special emphasis on the events of Tetovo) in two aspects:

- in the aspect of Yugoslavian internal relations and
- in the aspect of international relations.

In the aspect of domestic politics, the Socialist Federal Republic of Yugoslavia in the Cold War period, in the sixties, tried to play the role of a "promoter" in the Non-Aligned Movement. Such a policy was in function of camouflaging internal problems in fragile interethnic relations.

Albanians were in a position of discrimination since the end of World War II. In 1966, in the Brioni Plenum, the time when from the political scene was discharged one of the greatest anti-Albanian politicians, Aleksandar Ranković, the way for the outbreak of the Albanian revolt against the systematic oppression is opened.

In the aspect of international relations, 1968 is the year of many crises, among which a special place took the student movements in different countries of Europe, with political leftist tendencies, in whose manifestations dominated the opposition to the Vietnam War.

Events in Czechoslovakia were a special chapter in international developments, as well as Soviet military intervention. The events above exposed the sovjet doctrine of intervention, a process that had just begun, so the beginning of the end of the communist system.

Keywords: demonstrations, anti-Albanian politics, student movement, resistance.

68-ta TETOVARE NË KONTEKST TË RRETHANAVE JUGOSLLAVE DHE NDËRKOMBËTARE

Zeqirja Rexhepi

Abstrakt

Demonstratat shqiptare të vitit 1968 në Maqedoni janë pjesë e rezistencës gjithkombëtare në ish-Jugosllavi. Këto janë zhvilluar si rrjedhojë e një politike antishqiptare, pas Luftës së Dytë Botërore.

Në këtë punim shkencor do të përpiqem që ngjarjet e vitit 1968 (me theks të veçantë ngjarjet e Tetovës) ti trajtoj në dy rrafshë:

- në rrafshin e marrëdhënieve të brendshme jugosllave dhe
- në rrafshin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Në rrafshin e politikës së brendshme, Jugosllavia Socialiste në periudhën e Luftës së Ftohtë, vitet gjashtëdhjeta, përpiqet të luajë rolin e “promotorit” në Lëvizjen e të Painkuadruarve. Një

politikë e këtitllë ishte në funksion të kamuflimit të problemeve të brendshme në marrëdhëniet e brishta ndëretnike.

Shqiptarët ndodheshin në pozitë diskriminimi nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1966, në Plenumin e Brioneve, koha kur nga skena politike shkarkohet njëri nga politikanët më të mëdhenj antishqiptar, Aleksandër Rankoviçi, hapet rruga e shpërthimit të revoltës së shqiptarëve kundër shtypjes sistematike.

Në rrafshin e marrëdhënieve ndërkombëtare, viti 1968 është viti i krizave të shumta, ndër të cilat vend të veçantë zënë lëvizjet studentore në vende të ndryshme të Evropës, me prirje të majta politike, në manifestimet e të cilave dominonte kundërshtimi i luftës së Vietnamit.

Ngjarjet në Çekosllovakia ishin një kapitull i veçantë në zhvillimet ndërkombëtare, sikurse dhe intervenimi ushtarak sovjetik. Ngjarjet në fjalë e shpalosën doktrinën sovjetike të intervenimit, një proces që sapo kishte filluar, pra fillimi i fundit të sistemit komunist.

Fjalët kyçe: demonstrata, politika antishqiptare, lëvizja studentore, rezistenca.

Rendi Ndërkombëtar i vendosur Jaltë (1944), në themel të së cilit qëndronte ndarja e “sferave të ndikimit” midis Bllokut Perëndimor dhe Bllokut Lindor, do të ndërtojë dy botë të ndryshme me kundërthënie permanente. Në kuadër të sferës së ndikimit, të dy blloqet kanë ngritur sistemet mbrojtëse: Aleanca Veriatlantike që përkujdesej për mbrojtjen e Bllokut Perëndimor, sistemin shumëpartiak dhe ekonominë e tregut dhe Traktati i Varshavës që mbronte Bllokun Lindor, gjegjësisht sistemin monist dhe ekonominë e shtetëzuar.

Gjatë periudhës së pasluftës së dytë, që njihet si *Luftë e Ftohtë*, janë vërejtur “ngacmime” përtej vijës së demarkacionit, që njihet si “*Perdja e Hekurt*”. “Ngacimet” e përmendura patën si objektiv gjithnjë zgjerimin e “sferës së ndikimit”. Në këtë kontekst, në vitin 1952 përmendet *Nota e Stalinit*, që synonte largimin e RF. të Gjermanisë nga kampi perëndimor,¹ apo dhe *Strategjia e Dalles-it*, që synonte “çlirimin” e Evropës Lindore.² Mirëpo, zhvillimet historike dëshmojnë se të dy rastet përfunduan pa sukses: i pari për shkak të vdekjes së Stalinit (1953), ndërsa i dyti për shkak të dështimit të kryengritjes në Hungari (1956).

Në vitin 1968 Evropa ishte përfshirë nga vala e demonstratave, si në Lindje ashtu dhe në Perëndim. Lëvizjet reformatore në vendet e Bllokut Lindor synojnë t’eliminimin e mbetjeve të stalinizmit, ndërkaq në vendet e Bllokut Perëndimor, lëvizjet reformatore synojnë ta ndryshojnë mënyrën e qeverisjes.

Rrethanat në Jugosllavi

Ngjarjeve të vitit 1968 në hapësirën shqiptare i paraprin eliminimi nga skena politike e arkitektit të Sigurimit Shtetëror Jugosllav, Aleksandër Rankoviç-it dhe bashkëmendimtarëve të tij.

Në të vërtetë në aparatit komunist dhe në organet shtetërore jugosllave në fillim të viteve 60-të zhvillohej një luftë e ashpër midis dy grupeve kundërshtuese rreth zhvillimit shoqëroro-politik të Federatës: ithtarëve të politikës centraliste dhe ithtarëve të politikës decentralizuese. Kjo luftë e ashpër kishte arritur kulmin me të ashtuquajturën “afërë e përgjimeve”. Sipas dëshmimeve të kohës, Sigurimi Shtetëror Jugosllav kishte përgjuar një numër të madh funksionarësh politikë, midis të cilëve edhe vetë Tito-n. Afera në fjalë shërbeu si shkas për të shpalosur keqpërdorimet e Sigurimit Shtetëror, në krye të së cilës për shumë vite kishte qenë Aleksandër Rankoviçi.³

¹Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë, 1999, 595.

²Po aty, 595.

³https://sr.wikipedia.org/wiki/Брионски_Пленум_ЦК_СКЈ.

Më 16 qershor 1966, në mbledhjen e KQ të LKJ-së janë vënë në rend dite deformimet në punën e organeve të Sigurimit Shtetëror (UDB). Në të njëjtën mbledhje zgjidhet Komisioni Shtetëror-Partiak⁴, të cilit i jepet për obligim të shqyrtojë çështjen e ngritur, të përgjimeve. Gjashtë ditë më pas, Komisioni Shtetëror e paraqet *Raportin* rreth çështjes në fjalë.⁵

Çështja e deformimeve në Sigurimin Shtetëror Jugosllav merr epilogun e saj në mbledhjen e katërt plenare të KQ të LKJ-së, që njihet si *Plenumi i Brioneve*, i mbajtur më Brione të Istrisë, më 1 korrik 1966. Në këtë mbledhje, pas akuzave të shumta në adresë të Sigurimit Shtetëror dhe Aleksandër Rankoviç-it, i njëjti është shkarkuar nga të gjitha funksionet partiake dhe shtetërore, pra nga pozita e nënkryetarit të Jugosllavisë dhe sekretarit të KQ të LKJ-së.⁶

Rënia e Rankoviç-it nga skena politike jugosllave, një personaliteti që e ruante patronazhin e kontrollit mbi aparatit shtetëror, paraqet simbolikën e fitores së qarqeve decentralizuese, me çka hapet rruga për reforma rrënjësore të politikës shtetërore, në kuadër të ideologjisë ekzistuese (komuniste). Pra, rënia e Rankoviç-it shënon pike kthese, me ç'rast fillon demontimi i aparatit të tmerrshëm të policisë sekrete jugosllave. Kjo është periudha kur pushteti jugosllav e zbuti qëndrimin edhe kundrejt shqiptarëve.⁷ Në këto rrethana “lehtësuese”, edhe përkundër faktit se shqiptarëve nuk iu hoq diskriminimi, megjithatë në masë të caktuar mundën ta shprehnin pakënaqësinë për pozitën në Jugosllavi.

Në rrethana të reja, pas *Plenumit të Brioneve*, dhe ndryshimeve të filluara, në vjeshtë të vitit 1968, në shumë qytete shqiptare shpërthyen demonstrata. Më 25 tetor, gazeta “Rilindja” shkruan për demonstrata në Prizren, Pejë dhe Suharekë.⁸ Demonstratat e përmendura në qytete të ndryshme të Kosovës ishin pararendëse për ngjarjet që ndodhën në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë. Meqenëse po afrohej *Dita e Flamurit*, 28 Nëntori, në Prishtinë ndodhën manifestimi kryesor, në të cilin demonstruesit shqiptarë, përpos kërkesave për barazi, e shpалosin edhe kërkesën politike për Republikën e Kosovës.

Demonstratat në Kosovë, i vunë në lëvizje gjithandej strukturat politike të Lidhjes Komuniste. Kështu ndodhi edhe në Maqedoni. Menjëherë pas ngjarjeve në Prishtinë, më 9 dhjetor 1968, Sekretariati i KQ të LKM e aprovon dokumentin me titull “*Përfundime mbi disa probleme në politikën rreth çështjes kombëtare në RSM*”.⁹ në të cilin është dënuar pakënaqësia e shprehur e shqiptarëve në Kosovë.

Demonstratat shqiptare të Kosovës nuk mbetën ngjarje të izoluara, përkundrazi ato patën jehonë të gjerë edhe në qytetet shqiptare në Maqedoni. Si pjesë e një procesi politik, që tashmë kishte filluar në pranverë të vitit 1968,¹⁰ edhe pse me pak vonesë, edhe në Tetovë shpërthen pakënaqësia e akumuluar e shqiptarëve ndër vite. Sipas disa burimeve të shkruara për demonstratat e *Tetovarëve*, ngjarjet në Tetovë janë provokuar nga një nacionalist maqedonas, i cili e ka grisur flamurin kombëtar shqiptar më 22 dhjetor 1968.¹¹ Po kështu, sipas dëshmisë së Salih Salihut, një tetovar i dënuar për demonstratat e 1968-tës (citoj) “...në Tetovë nuk kishte klimë të tillë që mund të dyshohej se do të ndodhë ndonjë ngjarje e madhe sikur demonstratat që ishin organizuar kohë më parë në Kosovë... në Tetovë ndodhi një protestë e gjimnazistëve për hapjen e shkollave të mesme shqipe... grisja e flamurit shqiptar do të jetë shkaku i shpërthimit të demonstratës”... Nga të dhënat që ka grumbulluar për librin

⁴ Komisioni në përbërje: Kërste Cërvenkovski, Mika Tripalo dhe Franc Popit.

⁵ www.znaci.net/00001/138.92.pdf. Brionski Plenum-pad grupe A. Rankovica, Reorganizacije Federacije. Cetvrti plenum CK SKJ Titova Uvodna rec na Plenumu, Brioni, 1 jula 1966.

⁶ https://sr.wikipedia.org/wiki/Брионски_Пленум_ЦК_СКЈ.

⁷ Leonid Poliakov, *Totalitarizmat e shekullit XX, Tiranë (pa vit botimi)*, 201.

⁸ Marijana Stamova, *Faktori shqiptar në Republikën e Maqedonisë (1945-1981)*, 2014, 95.

⁹ Marijana Stamova, *Faktori shiptar...*105.

¹⁰ Po aty, 94.

¹¹ Po aty, 106.

e tij, *Ngjarje dhe dëshmi – diskriminimi i shqiptarëve në Maqedoni*, nga aktivistët e lëvizjes për demonstrata, del se në Tetovë demonstratat duhej të organizoheshin në pranverë të vitit 1969, (citoj): “sipas deklaratave të disa aktivistëve të Tetovës, iniciatorë për mbajtjen e demonstratave, të njëjtat ishin paraparë të mbareshin në pranverë të vitit 1969. Deri atëherë të bëheshin parapërgatitjet e duhura me kërkesa të detajuara, ku do të përfshiheshin të gjitha lëmitë për të drejtat e shqiptarëve dhe ndërprerjen e menjëhershme të statusit diskriminues të tyre”.¹²

Demonstratat e shqiptarëve në Tetovë padyshim se i vunë në gatishmëri maksimale organet më të larta partiake në Maqedoni. Me këtë rast, ngjarjet e Tetovës dhe kërkesat për më shumë të drejta janë karakterizuar si “nacionaliste, shoviniste dhe irredentiste”, duke theksuar se, “ekziston lidhja e drejtpërdrejtë midis ngjarjeve të Tetovës dhe atyre të Kosovës”.¹³

Rrethanat ndërkombëtare

Pas vendosjes së diktaturës ushtarako-politike në Evropën Lindore dhe Juglindore, propaganda komuniste *de jure* trumbetonte për “demokraci popullore”, por në praktikë sistemi komunist sovjetik kishte marrë fizionomi të një sistemi kolonialist, prapa të cilës fshihej shfrytëzimi ekonomik i masave popullore dhe diskriminimi kombëtar i popujve të vegjël në favor të popujve të mëdhenj.

Në arenën ndërkombëtare, pas ngjarjeve rreth krizës së Berlinit dhe krizës së Kubës, në vitet 60-ta, zhvillimet ndërkombëtare karakterizohen me një nga krizat më të mëdha në të cilat janë konfrontuar Blloku Perëndimor dhe Lindor – Lufta e Vietnamit. Në të vërtetë, në këtë çështje ishte zhytur Amerika, në emër të mbrojtjes së vlerave të sistemit perëndimor.

SHBA si njëra nga fuqitë më të mëdha antikomuniste të Perëndimit, tek e cila mund të mbështetej kauza e lirisë kombëtare, në periudhën kur filluan ndryshimet dhe më pas edhe demonstratat e 68-tës, ishte e preokupuar kryesisht me çështjen e Vietnamit. Edhe përkundër faktit se, në mesazhin e tij inaugurues, presidenti amerikan, Xhon Kenedi, më 20 janar 1961, thotë: “Le ta dijë çdo vend që na do të mirën apo të keqen, se ne do të bëjmë çdo sakrificë, do të mbajmë çdo barrë, do të përballojmë çdo vështirësi, do të përkrahim çdo mik, do të kundërshtojmë çdo armik, për të siguruar ekzistencën dhe fitoren e lirisë”.¹⁴ Megjithatë, SHBA, gjatë vitit 1968, kohë kur ndodhën ngjarjet shqiptare, ishin përqendruar në zgjidhjen e krizës së Vietnamit, e cila padyshim ishte çështje parësore për politikën e jashtme amerikane. Angazhimi ushtarak e diplomatik amerikan në Vietnam kishte marrë tashmë përmasa të gjera,¹⁵ gjë nënkupton se Amerika në Vietnam përpiquej të mbrojë “linjën e demarkacionit” midis Bllokut Perëndimor dhe Lindor, që *de facto* ishte “shkelur” si rezultat i ekspansionit të ideologjisë komuniste. Në këto rrethana, kur marrëdhëniet ndërkombëtare ishin fokusuar në përpjekjet për ruajtjen e “linjës së demarkacionit” midis dy blloqeve, nuk mund të shpresohej shumë në ndihmën e Perëndimit, apo më saktë të SHBA-së, për ndonjë trysni eventuale diplomatike.

Nga ana tjetër, edhe vendet e Perëndimit, në vitin 1968 është përfshirë nga vala e madhe e demonstratave.

¹² Salih Salihu, *Ngjarje dhe dëshmi – diskriminimi i shqiptarëve në Maqedoni*, Tetovë, 2011, f. 63.

¹³ Marijana Stamova, *Faktori shqiptar...*, 107 (Fjala e Sekretarit të KQ të LKM, Angel Çemerski, më 28 dhjetor 1968).

¹⁴ Henry Kissinger, *Diplomacia...* 622.

¹⁵ Po aty, 658 (*Public Papers of the Presidents of the United States: John F. Johnson, vëll. 1965 (Washington, D.C.: U.S. Government Printing Office, 1966), f. 72*).

Ngjarjet kryesore në Perëndim janë zhvilluar në Francë, që në histori njihen si “*Maji Francez*”¹⁶. Në këto ngjarje mijëra protestues, si: studentë, punëtorë dhe intelektualë ishin ngritur kundër qeverisjes së Charl De Gol-it.

Fillet e ngjarjeve në Francë ndodhën në Universitetin *Nanterre* (jashtë Parisit), në muajin mars 1968, fillimisht si protesta kundër luftës në Vietnam. Qeveria franceze për të shtypur protestat e angazhoi policinë, duke përdorur dhunë, me ç’rast reagoi opinion publik francez. Zhvillimet në Francë janë përshkallëzuar, duke përfshirë tërë Francën.

Demonstruesit francezë, patë kërkesa të ndryshme drejtuar qeverisë së Charl Dë Gol-it, si: studentët pjesëmarrës kërkonin heqjen e kontrollit politik nga universitetet, punëtorët kërkonin rritjen e pagave, ndërsa intelektualët u ngritën kundër shtypjes policore. Në ballë të protestave ishte edhe njëri nga filozofët e famshëm francez të shekullit XX, Zhan Pol Sartri.

Vlen të theksohet demonstratat në Francë kanë përfunduar me sukses, me ç’rast kërkesat e demonstruesve janë plotësuar pothuajse në tërësi, fakt që ka ndikuar që në Perëndim protestat dhe demonstratat patën si epilog avancimin e *shtetit të mirëqenies sociale*.

Mirëpo, diçka e ngjashme nuk do të ndodh në Lindje, përkatësisht në vendet e Bllokut Lindor.

Në vendet e Bllokut Lindor - komuniste, pas vdekjes së Stalinit (1953), zhvillimet historike hynë në një fazë që njihet si “*destalinizim*”, por që nuk nënkuptonte edhe demokratizim të shoqërisë.

Në vitet 60-ta, pas largimit të Hrushovit, në krye të Bashkimit Sovjetik ishte vendosur Leonid Brezhnjevi, cili njihet si lider komunist që e fiku dritën e shpresave, e cila ndizet në kohën e Hrushov-it.¹⁷ Lideri i ri sovjetik ishte themelues i konceptit të “*sovrانيتit të kufizuar*”, që nënkuptonte se shtetet dhe kombet që ndodhen në kuadër të Bllokut Lindor mund të jenë sovraane vetëm në korniza të ideologjisë komuniste – sovjetike.

Për dallim nga Perëndimi, në Lindje protestat dhe demonstratat e varrosën shpresën për ndryshime shoqërore në kuadër të doktrinës komuniste – sovjetike. Mirëpo, ngjarjet e Çekosllovakisë do të kontribuojnë për rrënimin e themeleve të sistemit komunist, që do të ndodhë njëzet vjet më vonë, me rënien e Murit të Berlinit (1989).

Në pranverë të vitit 1968 komunistët në Çekosllovakia, në krye me Aleksandër Dubçek-un, kishin shpallur “socializmin demokratik” që nënkuptonte një rrugë të tretë, pra as komunizëm Stalinist dhe as kapitalizëm liberal. Në të vërtetë, ngjarjet në fjalë kishin filluar që në verën e vitit 1967, atëherë kur studentët dhe intelektualët kishin nisur të protestonin kundër politikës së komunistëve dhe liderit Aleksandër Novotni.

Më 5 janar 1968 në krye të komunistëve çekoslovakë erdhi sllovaku Aleksandër Dubçek, një komunist i cili synonte ta liberalizonte sistemin komunist çekoslovak, me më shumë *liri shtypi, liri mbledhjeje, liri udhëtimi, reforma ekonomike, reforma gjyqësore*, etj. Ndër reformat e para të Dubçek-ut ishte eliminimi i censurës së aparatit shtetëror. Më pas ai vendosi lirinë e shtypit, lirinë e fjalës, lirinë e lëvizjes dhe liberalizimin e prodhimit dhe ekonomisë së tregut. Vlerat e reja që i vendosi Dubçeku në Çekosllovakia i hapën rrugë debatit të gjerë publik. Me këtë, proceset në këtë vend Çekosllovakia lëviznin drejt sistemit pluralist, proces ky që shndërrohet të ashpër kombëtare kundër të kaluarës njëzetvjeçare. *De facto* ky proces i hap rrugë rrënimin të themeleve të sistemit komunizmit, me çka vendosej në pikëpyetje fitorja e Partia Komuniste, në zgjedhjet eventuale.

Procesi reformues në Çekosllovakia bjen ndesh me “Doktrinën Brezhnjev”. Në këto rrethana, në prill 1968 udhëheqja sovjetike i shpreh rezervat e para, duke provokuar në forma

¹⁶www.ballkanweb.com/Viti_1968: 50 vjet nga “*Maji francez*”, ose revolucioni “*dështuar*”. Si u ngritën studentët.

¹⁷ Leonid Poliakov, *Totalitarizmat...*, 129.

të ndryshme presioni, si: paralajmërimet, lëvizjet e trupave ushtarake, manovra ushtarake, etj. Këtyre provokimeve opinioni publik në Çekoslovaki do t'i kundërpërgjigjet.¹⁸

Sipas dëshmive historike, më 13 gusht 1968, udhëheqësi sovjetik, Leonid Brezhnjev, ndodhej për pushime në Jaltë. Sipas tyre, më 13 gusht 1968, është zhvilluar një bisedë telefonike midis liderit Brezhnjev-it dhe Dubček-ut. Udhëheqësi sovjetik, gjatë kësaj bisede ka kërkuar nga Dubčeku largimin e tre reformatorëve radikalë dhe trajtimin më të rreptë kundër medimeve. Në këto rrethana, Dubčeku ka ofruar dorëheqje.

Disa ditë pas “bisedës telefonike” midis Brezhnjev-it dhe Dubček-ut, më 21 gusht 1968 (ora 4 e mëngjesit), kur tashmë vendimi ishte marrë, ushtria sovjetike (Traktati i Varshavës) e rrethon objektin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste në Pragë, duke hyrë me forcë në zyrën e Aleksandër Dubček-ut. Me këtë, tragjedia çekosllloake tashmë kishte filluar.

Kur flitet për rrethanat ndërkombëtare, nuk mund të anashkalohet edhe shteti shqiptar dhe qëndrimi zyrtar i tij, rreth ngjarjeve shqiptare të vitit 1968 në Jugosllavi.

Në parim, Shqipëria nuk mund të ishte kundër kërkesave të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, në themel të cilave qëndronte mbrojtja e veçantive kulturore, përfshi edhe simbolet kombëtare, por lufta për identitet kombëtar nuk mund të përkrahej nga shteti shqiptar nëse nuk bazohej në ideologjinë marksiste-leniniste.¹⁹ Pra, mbështetja e Shqipërisë ishte e kufizuar në korniza të ideologjisë marksiste. Në artikullin “*Shqiptarët e Kosovës dhe flamuri kombëtar*”, të organit të PPSH-së, “Zëri i Popullit”, datës 24 nëntor 1968, lidhur me kërkesat e shqiptarëve të shprehura në demonstratat në Kosovë, mes tjerash thuhet: “*Ne, si kurdoherë, do t'i mbrojmë në rrugë marksiste-leniniste, vëllezërit tanë kosovarë...*”²⁰

Shqipëria zyrtare i mbështeste kërkesat e shqiptarëve për më shumë të drejta dhe identitet kombëtar, por nga ana tjetër ishte tepër e kujdesshme kur ishte fjala për kërkesën *Kosova – Republikë*. Shteti shqiptar, çështjen e Kosovës e shihte si çështje e të drejtave kombëtare në kuadër të Federatës Jugosllave. Arsyet e një qëndrimi të këtillë të shtetit shqiptar duhet kërkuar tek detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë, e cila ishte e detyruar të respektojë marrëveshjet ndërkombëtare të pasluftës, rreth çështjes së ruajtjes së sovranitetit territorial. Mbështetja eventual e kërkesës për Republikën e Kosovës mund të konsiderohej si pretendim territorial ndaj Jugosllavisë, gjë që binte ndesh me marrëveshjet ndërkombëtare të Konferencës së Paqes së Parisit (1946), sipas të cilës Shqipëria ishte e obliguar ti respektojë kufijtë shtetëror.

Fakti që Shqipëria zyrtare i mbështet kërkesat për avancimin e të drejtave shqiptarëve, por jo edhe kërkesën kyçe politike, Kosova-Republikë, duhet analizuar në kontekstin kohor të rrethanave, në të cilat ndodhej shteti shqiptar. Duhet theksuar se, Shqipëria ishte tërësisht e vetmuar përballë një Jugosllavie, e cila në këtë kohë gëzon një reputacion ndërkombëtar (Perëndim) që kishte filluar me kundërshtimin ndaj Stalinit (periudha e Informbyro-së - 1948) dhe më pas përmes rolit të saj në Lëvizjen e të Paangazhuarve.

Në kohën e ngjarjeve të demonstrative të vitit 1968, Shqipëria ishte në fazën e kërkimit të “aleatit të madh”, siç ishte Kina komuniste. Me të cilën në tetor-nëntor 1968 shkëmben delegacione të nivelit të lartë partiak.²¹

Në qoftë se politika është “art i së mundshmes”, atëherë mund të thuhet se Shqipëria në ato rrethana historike bëri të mundshmen për mbështetjen e kërkesave të shqiptarëve në Jugosllavi.

¹⁸ Leonid Poliakov, *Totalitarizmat...* 199.

¹⁹ Sabit Sylaj, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës, 1939-1981*, Instituti i historisë, Prishtinë, 2002, 173.

²⁰ Po aty, 174.

²¹ Leonid Poliakov, *Totalitarizmat...* 201.

PËRFUNDIM

Ngjarjet e vitit 1968 në Tetovë padyshim janë pjesë e zhvillimeve të përgjithshme politike që ndodhën në Jugosllavi dhe më gjerë në Evropë, si rezultat i përpjekjeve për reforma politike. Në fokus të temës sime janë ngjarjet e vitit 1968 tek shqiptarët, me theks demonstratat e Tetovës, duke i prezantuar ato në kontekstin e rrethanave jugosllave dhe evropiane.

Pas Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët në Jugosllavi u ndodhën në pozitë diskriminuese, të shtypur nga aparati i diktaturës komuniste, shërbimi sekret i UDB-së. Në krye të këtij institucioni, instrument i diktaturës jugosllave, për një kohë të gjatë ishte njëri nga politikanët më të mëdhenj serb, Aleksandër Rankoviçi. Ndërkohë që, në vitin 1966, në Plenumin e Brionëve, Rankoviçi eliminohet nga skena politike, duke i hapur rrugë procesit të ndryshimeve në ish-Jugosllavi. Pikërisht kjo është koha kur ndodh revolta e shqiptarëve kundër pozitës diskriminuese dhe shtypjes sistematike.

Raportet ndërkombëtare nuk ishin në favor të kauzës shqiptare, të vitit 1968. Në Bllokun Perëndimor, në vitet 60-ta jo që nuk kishte unitet rreth çështjeve strategjike, por ekzistonin mosmarrëveshje të thella midis *strategjisë ushtarake të kontrollit në Evropë* (në epokën bërthamore), që mbështetej nga SHBA dhe nga ana tjetër *autonomi më të madhe të Evropës*, që mbështetej nga Franca.

Nga këndvështrimi historik, ngjarjet shqiptare të 68-ës (edhe ato në Tetovë) mbetën në “hije” të “Pranverës së Pragës” apo “Majit Francez”. Ato mbetën të “izoluara” në korniza të ndryshime jugosllave. Megjithatë e kanë rëndësinë e veçantë për historinë kombëtare shqiptare, sepse ato ngjarje ushtruan presion të madh në rrjedhat politike të kohës, gjatë kohës së ndryshimeve juridike dhe vendosjen e Kushtetutës së vitit 1974, e cila ndonëse shqiptarët nuk i barazoi me popujt tjerë të Federatës Jugosllave, por u mundësoi zhvillim të identitetit kulturor.

BURIMET DHE LITERATURA E SHFYRTËZUAR

Kissinger, Henry, *Diplomacia*, Tiranë, 1999.

Poliakov, Leon, *Totalitarizmat e shekullit XX*, Tiranë (pa vit botimi).

Stamova, Mrijana, *Faktori shqiptar në Republikën e Maqedonisë (1945-1981)*, 2014.

Salihu, Sali, *Ngjarje dhe dëshmi – diskriminimi i shqiptarëve në Maqedoni*, Tetovë,

Syla, Sabit, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës, 1939-1981*, Instituti i historisë,

Prishtinë, 2002.

Xhonsón, Pol, *Kohët moderne 2, Apollonia*, 2000.

https://sr.wikipedia.org/wiki/Брионски_Пленум_ЦК_СКЈ.

www.znaci.net/00001/138.92.pdf. Brionski Plenum-pad grupe A. Rankovica,

Reorganizacije Federacije. *Cetvrti plenum CK SKJ Titova Uvodna rec na Plnumu*, Brioni, 1 jula 1966.

https://sr.wikipedia.org/wiki/Брионски_Пленум_ЦК_СКЈ.

www.ballkanweb.com/Viti_1968:_50_vjet nga_“Maji_francez”,_ose_revolucion_i_“deshtuar”_.Si_u_ngritën_studentët.

“dështuar”. Si u ngritën studentët.